

4. AUDITIMI I BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm në Bankën e Shqipërisë realizohet nga Departamenti i Kontrollit. Objektivi kryesor i tij është të sigurojë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë. Funkzioni i auditimit të brendshëm u siguron Administratorëve të Bankës, në mënyrë periodike dhe të pavarur, verifikimin dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke testuar kontrollet dhe procedurat e caktuara, por duke mos qenë një zëvendësues i tyre.


4.1 ZHVILLIME TË RËNDËSISHME NË AKTIVITETIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM GJATË VITIT 2017

Vënia në zbatim e Politikës së Auditimit të Brendshëm

Me miratimin e Politikës së Auditimit të Brendshëm dhe rishikimin e Rregullores së funksionimit të Departamentit të Kontrollit, procesi i shqyrtimit dhe miratimit të Planit vjetor të Auditimit të Brendshëm në Bankën e Shqipërisë u realizua në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Plani vjetor për vitin 2017 u hartua nga Departamenti i Kontrollit dhe Inspektori i Përgjithshëm dhe iu paraqit për shqyrtim Komitetit të Auditimit. Më tej, ky plan i dakorduar nga Komiteti i Auditimit, u paraqit në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, ku u miratua me vendimin nr.7, të datës 01.02.2017.

Implementimi dhe përdorimi i aplikacionit për auditimin e brendshëm dhe menaxhimin e rrezikut

Gjatë vitit 2017, nisi implementimi i aplikacionit për menaxhimin e automatizuar të auditimeve dhe të procesit të menaxhimit të rrezikut operacional. Kështu, gjatë muajit prill, stafi i Departamentit të Kontrollit dhe ai i Njësisë së Rrezikut Operacional u trajnuan mbi përdorimin e tij dhe opsionet më të reja të ofruara nga ky sistem. Më pas, stafi punoi mbi popullimin e sistemit me të dhënat historike të auditimit të brendshëm dhe rrezikut operacional. Me implementimin e sistemit të ri, u rishikua universi i auditimit të Bankës së Shqipërisë, sipas funksioneve dhe proceseve të unifikuara edhe për nevoja të menaxhimit të rrezikut operacional. Gjatë vitit 2018, pritet që pjesa më e madhe e aktivitetit të auditimit të brendshëm të realizohet dhe dokumentohet në sistemin e ri.



Zbatimi i metodologjisë për vlerësimin e rrezikut për nevoja auditimi nëpërmjet aplikacionit të auditimit të brendshëm

Plani i propozuar për vitin 2018, u bazua në procesin e vlerësimit të rrezikut për qëllime auditimi nëpërmjet aplikimit për herë të parë të planifikimit me sistemin e ri Pentana. Planifikimi i bazuar në rrezik nëpërmjet këtij sistemi, rrit cilësinë e planifikimit bazuar në rreziqet e identifikuara gjatë auditimit dhe gjatë përditësimit të universit të auditimit me rreziqet dhe proceset e identifikuara në vazhdimësi nga administrimi i rrezikut operacional.

Ky proces ezauron edhe një nga çështjet e identifikuara nga Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë (*External Quality Assessment*), që u zhvillua nga Banka Qendrore e Holandës në vitin 2015, duke realizuar një plan auditimi të bazuar plotësisht në rrezik.

Konsolidimi i marrëdhënieve me njësinë ARO

Me krijimin e njësisë së Administrimit të Rrezikut Operacional (ARO) në vitin 2016, si dhe me miratimin e Politikës për Administrimin e Rrezikut Operacional e Rregullores së funksionimit të kësaj njësie, u konsoliduan linjat e raportimit dhe bashkëpunimit midis kësaj njësie dhe Departamentit të Kontrollit për përmbushjen e objektivave të secilës palë.

Njësia ARO, në fillim të çdo auditimi, vë në dispozicion të grupeve të auditimit (inspektorëve të kontrollit) listën e rreziqeve operacionale që janë identifikuar, administrohen dhe monitorohen nga ARO. Ndërkohë, Departamenti i Kontrollit vë në dispozicion të Njesisë ARO në përfundim të çdo angazhimi, raportin e auditimit, vlerësimin e rrezikut të funksionit dhe gjetjeve, formatin procese-kontrolle-rreziqe, si dhe çdo informacion tjetër që mund t'i vlejë procesit të administrimit të rrezikut operacional, përveç raportimit mujor të rreziqeve operacionale që lidhen me vetë auditimin e brendshëm.

Implementimi i rekomandimeve të vlerësuesve të jashtëm dhe rezultatet e vlerësimit të brendshëm

Gjatë vitit 2017, Departamenti i Kontrollit realizoi angazhimin "Vetëvlerësimi i Cilësisë së Auditimit të Brendshëm", bazuar në orientimet e IIA (*The Institute of Internal Auditors*) dhe në standardet e tij mbi vlerësimin e funksionit të auditit të brendshëm (*Quality Assessment*). Ky angazhim, përtej përmbushjes së objektivit kryesor për vlerësimin e cilësisë së Auditimit të Brendshëm, përmbush dhe një nga rekomandimet e lëna nga Projekti mbi vlerësimin e jashtëm të cilësisë së Auditimit të Brendshëm (*External Quality Assessment*), realizuar nga Banka Qendrore e Holandës në maj të vitit 2015.


Në përfundim të këtij angazhimi, Departamenti i Kontrollit vlerësoi përputhshmërinë e aktivitetit të auditimit të brendshëm me praktikatat ndërkombëtare profesionale (Standardet/IPPF), si dhe vlerësoi gjendjen aktuale



të rekomandimeve të lëna nga vlerësuesi i Jashtëm (EQA). Tabela në vijim tregon situatën në fund të vitit 2017 lidhur me rekomandimet e vlerësuesve të Jashtëm (EQA) realizuar nga Banka Qendrore e Holandës dhe rezultatet e angazhimit të vetëvlerësimit të auditimit të brendshëm:

Nivelet e përputhshmërisë sipas EQA	Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së AB (EQA) 2015	Vetëvlerësimi i cilësisë së AB (IQA) 2017
Nuk përputhet	14	-
Përputhet pjesërisht	29	16
Përputhet	61	88
TOTALI	104	104


Grafik 52. Vlerësimi i cilësisë së auditit të brendshëm (EQA, 2015) dhe vetëvlerësimi i cilësisë (2017)



Sipas paraqitjes së mësipërme, vetëm 15% e standardeve nuk janë plotësisht të zbatuar (në përputhje me praktikën më të mirë të parashikuar nga IPPF e Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm).


4.2 TREGUES TË PËRGJITHSHËM MBI DEPARTAMENTIN E KONTROLLIT

Në përputhje me Ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, objektivi kryesor i Departamentit të Kontrollit është të sigurojë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, si dhe të veprojë si një masë kontrolli e përgjithshme dhe shërbim konsulence për Administratorët dhe Këshillin Mbikëqyrës, duke dhënë ndihmesën e tij në drejtim të ruajtjes së integritetit të informacionit, përdorimit eficient të burimeve dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë.



Struktura organizative e Departamentit të Kontrollit

Gjatë vitit 2017, struktura organizative e drejtuar nga Inspektori i Përgjithshëm ka qenë pothuajse e plotë dhe me burimet e nevojshme për t'u angazhuar.



Rritja profesionale e stafit dhe trajnimi i vazhdueshëm

Në funksion të përmbushjes së objektivit strategjik për rritjen profesionale të audituesve të brendshëm, inspektorët e kontrollit janë përfshirë në programe trajnimi për auditimin e brendshëm dhe për menaxhimin e rrezikut të ofruar nga bankat qendrore dhe njëkohësisht kanë ndjekur programe individuale për zhvillimin e tyre profesional dhe për dhënien e provimeve profesionale për anëtarësime/certifikime pranë institucioneve ndërkombëtare në fushën e financës dhe auditimit. Gjatë vitit 2017, inspektorët e kontrollit kanë iniciuar dhe vijuar ndjekjen e programeve për certifikimet profesionale ACCA, CIA, CISA, si dhe kanë ndjekur orët minimale të detyrueshme për ruajtjen e titujve CIDA, ACCA, EKR⁴⁷.

⁴⁷ ACCA - Association of Chartered Certified Accountants (Shoqata e Audituesve të Certifikuar)
 CIA - Certified Internal Auditor (Auditues i Brendshëm i Certifikuar),
 CISA - Certified Information Systems Auditor (Auditues i Certifikuar i Sigurisë së Informacionit)
 CIDA - Certified Investments and Derivatives Auditor (Auditues i Certifikuar i Derivatëve dhe Investimeve),
 EKR - Ekspert Kontabël i Regjistruar (Auditues Ligjor).



4.3 ANGAZHIMET E KRYERA GJATË VITIT 2017 DHE PROBLEMATIKAT KRYESORE TË EVIDENTUARA

Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2017 janë fokusuar në: (i) dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontroleve të brendshme të vendosura nga drejtimi për funksionet/proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve; dhe (ii) angazhime të tjera audituese dhe joaudituese të paplanifikuara me kërkesë të veçantë nga Administratorët apo institucione të tjera jashtë Bankës.

Gjatë vitit 2017, u adresuan gjithsej 48 rekomandime të reja të rezultuara nga 7 angazhime auditimi për dhënie sigurie, duke mos përfshirë sugjerimet e rezultuara nga angazhimet e këshillimit dhe angazhimi mbi "Vetëvlerësimin e cilësisë së auditimit të brendshëm në BSh". Gjetjet dhe rekomandimet për secilin prej auditimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe janë adresuar fillimisht pranë drejtuesve të njëjësive për komente dhe më pas pranë Administratorëve të Bankës së Shqipërisë.

4.4 ZHVILLIME TË RËNDËSISHME NË ECURINË E ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT OPERACIONAL GJATË VITIT 2017


Banka e Shqipërisë pas përfundimit me sukses të projektit "Për implementimin e kuadrit për administrimin e rrezikut operacional në nivel Banke" në qershor të vitit 2016, arriti në harkun kohor të një viti të ndërtojë infrastrukturën e duhur, funksionalitetin dhe eficiencën e njësisë përgjegjëse për Administrimin e Rrezikut Operacional.

Objektivi i Administrimit të Rrezikut Operacional është të miradministrojë pasiguritë, si dhe të informojë e të ndihmojë procesin e vendimmarrjes mbi rreziqet që mund të pengojnë arritjen e objektivave të Bankës së Shqipërisë, apo të kenë ndikime negative financiare dhe/ose reputacionale.

Vlerësimi i nivelit të Administrimit të Rrezikut Operacional nga ekspertët ndërkombëtarë

Viti 2017 ka qenë periudha e konsolidimit të funksionit të Administrimit të Rrezikut Operacional në Bankën e Shqipërisë. Kjo u arrit në sajë të: a) shprehjes së tolerancës për rrezikun operacional nga Këshilli Mbikëqyrës; b) hartimit dhe miratimit të planeve të veprimit pranë Administratorëve; c) rishikimit dhe rivlerësimit periodik të databazës së rreziqeve operationale nga Njësia ARO.

Në sajë të këtyre zhvillimeve, niveli i maturitetit të aktivitetit të ARO (vlerësuar nga ekspertët ndërkombëtarë IORWG), pati një rritje të konsiderueshme në nivelin 69.22% për vitin 2017 (nga 50.32% në fund të vitit 2016). Kjo konsiderohet faza fillestare e nivelit të tretë të vlerësimit të rrezikut si "I menaxhuar" ($\geq 69\%$ i përket këtij niveli III).



AD-HOC	BAZIK	I MENAXHUAR	I AVANCUAR	I MATURUAR
<61%	≥61%	≥69%	≥86%	≥94%

Vlerësimi është kryer nga Grupi Ndërkombëtar i Punës për Rrezikun Operacional (IORWG), pjesë e të cilit është edhe Banka e Shqipërisë. Kjo organizatë është e përbërë nga 70 banka qendrore dhe funksionon prej muajit tetor të vitit 2005. Në vijim të këtij procesi, progresi i nivelit të maturitetit të administrimit të rrezikut operacional ka kaluar nga 'ad-hoc' në 'i menaxhuar', duke kapërcyer nivelin 'bazik'. Ky vlerësim është në tejkallim të pritshmërive të objektivave të Bankës së Shqipërisë për fundin e vitit 2017.

Ky nivel maturiteti tregon që në politikën e menaxhimit të rrezikut, Bordi (Këshilli) përcakton implementimin e strukturës së menaxhimit të rrezikut, si dhe mbështet deklarimin e tolerancës ndaj rrezikut (*risk appetite*). Ekziston një matricë rreziku e përcaktuar dhe një strukturë qeverisëse me raportim direkt pranë Drejtimit të lartë. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet njësive të rrezikut është *ad-hoc* (sipas rastit) dhe periodik. Për vlerësimin dhe monitorimin e rreziqeve operacionale përdoren metoda cilësore dhe sasiore, të cilat mund të përfshijnë sipas rastit Tregues Kyç të Rrezikut (KRI), analizat e rreziqeve, incidenteve dhe humbjeve të brendshme. Gjithashtu, rezultatet e dala nga vlerësimi i njësisë së Administrimit të Rrezikut, merren në konsideratë në procesin e vendimmarrjes taktike/operacionale nga njësiti e Bankës së Shqipërisë.

Vlerësimi i pavarur certifikon nivelin e maturitetit nga një organizatë e pavarur ndërkombëtare dhe tregon rëndësinë e dhënë nga Banka dhe Këshilli Mbikëqyrës, funksionit të administrimit të rrezikut në Bankën e Shqipërisë, ndërgjegjësimit dhe edukimit të personelit në të gjitha nivelet për menaxhimin e rrezikut, gjë që ka ndikuar dhe do të ndikojë në mirëfunksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të funksioneve bazë dhe mbështetëse në kuadër të menaxhimit të rrezikut.

Rritja dhe implementimi i kulturës të rrezikut operacional në nivel banke

Një nga angazhimet kryesore të funksionimit të Njësisë ARO, është rritja e mëtejshme e kulturës së rrezikut operacional në nivel banke, për të arritur në një periudhë afatshkurtër objektivin e mirëfunksionimit të procesit ARO, ku synimi është që të gjithë punonjësit të kenë njohuritë e duhura dhe të flasin të njëjtën gjuhë, mbi rrezikun operacional.

Rëndësi e veçantë gjatë vitit 2017 iu kushtua standardit të raportimit të ngjarjeve/incidenteve, konsistencës së raportimit të ngjarjeve horizontale (që prekin disa njësi përveç asaj raportuese), ngjarjeve pothuajse të ndodhura, dhe njoftimit të menjëhershëm në rast të incidenteve me impakt të lartë.



Vijimi i projektit të radhës me rëndësi MVV (BCM) - Vijueshmëria e Veprimtarisë

Menaxhimi i vijueshmërisë së biznesit (BCM) është një proces i orientuar nga aktiviteti, i cili vendos një kuadër rregullativ strategjik dhe operacional të përshtatur sipas nevojave, për të:

- përmirësuar në mënyrë proaktive aftësinë rimëkëmbëse të organizatës ndaj ndërprerjeve operationale, të cilat e bëjnë të paaftë për të përmbushur objektivat kryesorë;
- siguruar një metodë rimëkëmbjeje të aftësisë së organizatës për të ofruar produktet dhe shërbimet në kohën dhe cilësinë e dakorduar pasi ndodh ndërprerja e aktivitetit;
- ofruar një aftësi të provuar për të menaxhuar ndërprerjen e aktivitetit dhe për të mbrojtur reputacionin e organizatës.

Gjatë vitit 2017 u punua për përzgjedhjen, organizimin dhe krijimin e Grupit të Punës që do të realizojë projektin për hartimin dhe implementimin e BCM në Bankën e Shqipërisë. Ky Grup Pune u krijua me Urdhrin e Guvernatorit nr.6025, datë 30.12.2016.

Në qershor 2017, grupi i punës organizoi një trajnim disaditor në bashkëpunim me ekspertët e jashtëm të dërguar nga Trupat Vullnetare të Shërbimeve Financiare (*Financial Services Volunteer Corps*). Krahas shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave më të mira për MVV, në këtë organizim, përfshihej një ditë kushtuar koordinatoreve të caktuar me ndjekjen e MVV-së me qëllim njohjen e tyre me tematika si: informacion i përgjithshëm për MVV-në, qëllimet kryesore, rëndësia e këtij programi për bankën etj.

Me përfundimin e projektit për Administrimin e Rrezikut Operacional në 2016, produktet dhe databazat e krijuara gjatë këtij projekti po shërbejnë si themel për ecurinë dhe finalizimin e projektit të sapoiniciuar për MVV në BSH. Tashmë me një kulturë më të rritur rreziku dhe dizenjimi/evidentimi të proceseve të punës nga të gjitha njësitë e BSH, projekti për vijueshmërinë e veprimtarisë ka bazën e nevojshme për të zhvilluar etapat e parashikuara në planin e projektit, të cilat së bashku me angazhimin e secilës njësi mund të garantojnë një përmbushje të suksesshme të objektivave.

Sinjalizimi si funksion i ri ligjor pranë Bankës së Shqipërisë

Në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 16.11.2016, Banka e Shqipërisë, si një autoritet publik i cili e plotëson kushtin ligjor për numrin e të punësuarve, ka detyrimin të përcaktojë një njësi përgjegjëse, e cila të trajtojë dhe hetojë sinjalizimet. Në zbatim të këtij vendimi si dhe ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", gjatë vitit 2017, u përcaktua struktura përgjegjëse për sinjalizimin në nivel banke,



si dhe personat përgjegjës, për të kryer funksionet për procesin e hetimit administrativ në vijim të sinjalizimit.

Gjithashtu gjatë vitit 2017, Banka e Shqipërisë hartoi dhe miratoi rregulloren e brendshme "Për hetimin administrativ të sinjalizimit, për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen nga hakmarrja në Bankën e Shqipërisë" me VKM nr.75, datë 06.12.2017. Kjo rregullore ka për qëllim që: a) të parandalojë dhe godasë korrupsionin në Bankën e Shqipërisë; b) të nxisë sinjalizimet mbi veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit; c) të mbrojë individët që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.

